

Positief Project

(Projekt pozitiv)

Ti je

- midis 12 dhe 18 vjeç
- dhe je përfshirë në një delikt rinor rreth të cilit u more në pyetje nga policia

Prokuroria ose gjyqtari për të rinjtë të ofron ty mundësinë e përpilimit të një projekti pozitiv. Mbase je penduar për çfarë ndodhi ose je duke kërkuar një mënyrë për ta rregulluar atë që bëre. Në këtë plan ti mund të marrësh përgjegjësi për pasojat e asaj që ndodhi.

Së bashku

- ne do të shikojmë se çfarë vajti keq
- cilat pasoja ka sjellë kjo: për ty, për viktimën dhe për njerëzit rreth teje
- dhe çfarë mund të bësh ti vetë për ta riparuar këtë

Si?

Së bashku ne do të kërkojmë një përgjigje rreth këtyre pyetjeve dhe do bëjmë një plan personal. Aty do të shkruhet se çfarë do të bësh ti për të zgjidhur problemet e mundshme ose për të mënjanuar situata të tilla në të ardhmen.

Për këtë ka disa mundësi:

- të bësh punë vullnetare
- të mësosh të bësh të qartë deri ku e ke kufirin
- ta kalosh ditën në mënyrë të dobishme
- të kërkos falje
- ...

Vertaling Nederlands-Albanees.

Dit is de vertaling Albanees van "Positief project" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Positief project".

Çdo i ri është ndryshe, prandaj edhe çdo plan është ndryshe. Ne do të nisemi nga zero dhe do të kemi parasysh çfarë të duket ty e rëndësishme. Ne do të dëgjojmë edhe prindërit e tu si dhe njerëzit pranë teje. Nëse personi që të ka referuar e aprovon planin, ne do të ndjekim ekzekutimin e planit. Pastaj ne do të shkruajmë një raport rreth projektit tënd pozitiv për prokurorin ose gjyqtarin e të miturve.

A e dije...

që ne e përfshijmë avokatin tënd në përpilimin e planit? Kjo është e rëndësishme sepse edhe avokati juaj duhet të japë aprovimin e tij për këtë plan. Ai/ajo do ketë kujdes që ky plan të jetë i drejtë ndaj teje dhe të respektojë të drejtat e tua. Në çdo moment gjatë trajektit ju mund të kontaktoni avokatin tuaj.